



No. 4133/PWA
16.07.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 455/1 prot.

Shkodër, më 16.07.2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 49, datë 26.06.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VOU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 3, pika 13, neni 22, pika 3, neni 27, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "f" dhe "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile", pika 3.1, shkronja "b", të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", të shkresës së AKMC nr. 446/2 prot., datë 20.02.2024 "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 4123 prot., datë 02.07.2024 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 26.06.2024", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 49, datë 26.06.2024 "Për një ndryshim të VKB Vau Dejës nr. 71, datë 28.09.2023 Mbi miratimin e objektit Ure Pasarelë me hapësirë drite HD 80 ml në fshatin Mnelë", me kod produkti 91707AG, "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve, me vlerë 2 847 585 lekë nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANÇONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 49 datë 26.06. 2024

Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.71 dt.28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit “Urë Pasarelë me hapësire drite HD 80 ml” në fshatin Mnelë e vogël

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, VKM nr.216 dt.13.04.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.” Pas diskutimit Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet e preventivit në objektin “ Urës pasarelë HD 80 ml në fshatin Mnelë e vogël ” të Njësisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës,si rezultat i zbatimit të VKM nr.216 dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si më poshtë vijon:

Ishte

Vlera e preventivit të miratuar në VKB Nr.71 dt.28.09.2023 **2.491.106.³²** leke (Dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtë (pike tridhjetë e dy) lekë , e cila ishte çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707AG sipas shkresës së AKMC nr.86/6 dt.27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile për vitin 2023.

Bëhet

Vlera e preventivit të azhornuar sipas VKM nr.216, dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim behet **2.847.585** lekë (dymilion e tetëqind e katërdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) e cila është çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707AG sipas shkresës së AKMC nr.446/2 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024”



2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të familjeve që banojnë në zonën ku ndodhet Ura.
3. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “sipas shkresës së AKMC Nr.446/6 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” per vitin 2024”.
4. **Ngarkohen për zbatim:** Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Prokurimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe financës) për zbatimin e këtij vendimi.
5. **Ky vendim** hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

Kryetar Këshilli

Ervis Shimag



Sekretar Këshilli

Andreas Ketepejo

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA MBROJTJES DHE EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM

Nr. 3 datë 14.06.2024

Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.71 dt.28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit “Urë Pasarelë me hapësire drite HD 80 ml” në fshatin Mnelë e vogël

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, Udhezimin Nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, VKM nr.216 dt.13.04.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”

Përsa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 dt.28.09.2023 të konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.644/1 dt.16.10.2023 , i propozon Këshillit Bashkiak që me shumice votash :

1. Të miratojë ndryshimet e preventivit në objektin “ Urës pasarelë HD 80 ml në fshatin Mnelë e vogël ” të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës,si rezultat i zbatimit të VKM nr.216 dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si më poshtë vijon:

Ishte

Vlera e preventivit të miratuar në VKB Nr.71 dt.28.09.2023 . **2.491.106.³²** leke (Dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtë (pike tridhjetë e dy) lekë , e cila ishte çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707AG sipas shkresës së AKMC nr.86/6 dt.27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile për vitin 2023.

Behet

Vlera e preventivit të azhornuar sipas VKM nr.216, dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e

punimeve në ndërtim behet **2.847.585** lekë (dymilion e tetëqind e katërdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) e cila është çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707 AG sipas shkresës së AKMC nr.446/2 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024”

2. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “sipas shkresës së AKMC Nr.446/6 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” per vitin 2024”.

Konfirmoi bazen ligjore

Jushin Shitani

Jushin Shitani

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Aleksandra GJONI



Vau Dejës, me 14.06.2024

Relacion

Objekti: "Ura Pasarelë HD(hapësirë drite) =80 ml në fshatin Mnelë e vogël Lagjia Rreth

Vendodhja: Mnelë e vogël, Njësia Administrative Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës

Grupi i punës verifikoi gjendjen në të cilën ndodhet ura pasarelë HD=80 ml në fshatin Mnelë e vogël (lagjia Rreth) gjatë vitit 2023 në zbatim të urdhrin të ngritur nga titullari i Bashkisë,Ura pasarelë HD 80 ml ndodhet në fshatin Mnelë e vogël të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës , në zonën kadastrale 2708 .

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e urës pasarelë , nga të cilat rezultoi se ura është 80 ml e gjatë. Ura Pasarelë është e ndërtuar me bazament betoni, ku paraqet dëmtime strukturore si në bazamentin e betonit ku duhen bërë përforcime dhe në shpatulla si dhe zevëndësim të dërrasave të dëmtuara.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit,që janë bërë gjatë vitit 2023 janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe përzgjedhja e zërave të punës janë bërë në mënyrë të tillë, që ura të rikthehet në gjendje optimale përdorimi (funksionimi). Por me daljen e VKM Nr.216 dt.13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim doli si domosdoshmëri ndryshimi i preventivit të bërë vitin e kaluar në të cilin kanë ndryshuar të gjitha zërat e punimeve si më poshtë vijon

Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë urë janë si më poshtë:

Gërmim shkambi i copëtuar me ekskavator 1.0 m3 ishte	15.786 leke
Struktura monolite betoni C 16/20	1.683.342 leke
F.V.hekur betoni periodik Ç -5, $\varnothing \geq 12$ m	123.770 leke
Shtresë me dërrasa 8 cm ishatebehet	501.227 leke
Bojë vaji sipërfaqe druri	48.863 leke
Shuma	2.847.585 leke(me TVSH)

Për Bashkisë Vau-Dejës në programin "Emergjencia Civile" për vitin 2024 në dëgën e thesarit ështëw depozituar shuma prej **2.847.585 lekë** për kodin **91707AG** –Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njërzëve

(sipas shkresës tonë nr.1247/1 dt.23.02.2024) në përgjigje shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.446/2 dt.20.02.2024 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024" që do të përdoret bazuar në Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave si dhe në VKM Nr.216 dt.13.04.2023 " Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Punoi :Ing.Gjovalin Paci

